

VENDIM
Nr. 579, datë 31.8.2022

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 270, DATË 2.5.2019, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PJESEMARRJEN E PERSONELIT TË FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MISIONIN E KOMBEVE
TË BASHKUARA NË SUDANIN E JUGUT (UNMISS)”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 2 e 5, të nenit 6, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të aktit normativ nr. 1, datë 20.3.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në misionin e Kombeve të Bashkuara në Sudanin e Jugut (UNMISS)”, miratuar me ligjin nr. 23/2019, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 1, të vendimit nr. 270, datë 2.5.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, data “15.3.2022” ndryshohet dhe bëhet “15.3.2023”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama